

**AKT THEMELIMI**  
**i Shoqërisë "Birra Jonë " Sh.p.k.**

Sot, me datë 15 / 05 / 2024,

**Znj. Rreze Masha**, shtetase shqiptare, lindur më 24.06.1990, banuese ne Tiranë, mbajtës i dokumentit kartë identiteti me ID J05624122J, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**Rreze" Sh.p.k.** (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1**

**EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "**Birra Jonë " Sh.p.k.**

**NENI 2**

**SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: **Njësia Bashkiake Nr. 5, Rruga Janos Hunyadi, Ndertesa nr.38, Hyrja 2, Kati 1, Kodi Postar 1019, Tiranë, Shqipëri.**

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

**NENI 3**

**KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

**NENI 4**

**OBJEKTI**

**Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:**

Import – Eksport I produktev te gatshme dhe gjysem te gatshme, si dhe lendeve te para per to kryesisht produkteve dhe nenprodukteve te birres. Kontraktimi me persona te ndryshem fizik apo juridik, vendas apo te huaj, per gjetjen e tregjeve te shitjes.. Konsulence dhe sherbime keshilluese per bizneset.

Ne pergjithesi shoqeria mund te kryeje çdo veprimtari te nevojshme e te dobishme te lejuar nga ligji per relizimin e objektit te aktivitetit te saj.

Shoqeria mundet gjithashtu te ushtroje cdo lloj tjetër biznesi apo aktiviteti te ligjshem dhe/ose mund te angazhohet ne cdo veprimtari te ligjshme ose aktivitet te lejueshem nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në

lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

## **NENI 5**

### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakut themelues në vlerën 100.000 (një qind mijë) Lekë dhe përbëhet nga 1 (nje) kuotë.

Kapitali themeltar përbëhet si më poshtë:

- **Znj. Rreze Masha**, zoteron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 100.000 (njëqind mijë) Lekë dhe 100.000 (njëqind mijë) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra me shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## **NENI 6**

### **ORGANET E SHOQËRISË**

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

-Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

-Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Znj. Rreze Masha**, shtetase shqiptare, lindur më 24.06.1990, banuese ne Tiranë, mbajtës i dokumentit kartë identiteti me ID J05624122J, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar e cila zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

## **NENI 7**

### **LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM**

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## **NENI 8**

### **DISPOZITA FINALE**

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë duke autorizuar Administratoren, **Znj. Rreze Masha**, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

## **ORTAKET THEMELUES**

**Rreze Masha**



